



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1409/3 Prot.

Tiranë, më 27.05 2025

V E N D I M

Nr. 63 datë 27.05 2025

“MBI
MIRATIMIN E REALIZIMIT TË SHËRBIMIT TË AKT-EKSPERTIZËS SË
THELLUAR PËR GODINËN E PALESTRËS SË GJIMNASTIKËS NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH, të Statutit të UST, neni 3, pika d), neni 38, të Rregullores së UST, të Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 4/1, “Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Me “auditim teknik” kuptohet akt ekspertiza e thelluar që vlerëson gjendjen teknike të një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse”, të VKM nr 26 datë 15.01.2020 “Për kryerjen e Akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, të VKM nr. 188 datë 13.03.2019, “Për ofrimin nga IPAL të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, të Relacionit nr. 1403 datë 26.05.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratohet shërbimi për realizimin e Akt-ekspertizës së thelluar për Godinën e Palestrës së Gjimnastikës në Universitetin e Sporteve të Tiranës
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASA

